

Vendim nr. 100 datë 15.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 15.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (I) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ILIR HOXHA**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 4070 (676), datë 05.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 145, datë 10.03.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2022-713, datë 23.06.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ilir Hoxha së bashku me shtetasin Sh. B. janë proceduar penalisht për kryerjen e disa veprave penale, për të cilat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 4070 (676), datë 05.10.2015, ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Hoxha për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe në bazë të neneve*

79/ë-25-22 të K.Penal dënimin e tij me 21 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Hoxha për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake ose municionit” dhe në bazë të nenit 278/2 të K. Penal dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Ilir Hoxha me një dënim të vetëm 23 vjet burgim.”. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim kërkuesi Ilir Hoxha dhe i pandehuri Sh.B.

2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 145, datë 10.03.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4070 (676), datë 05.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-713, datë 23.06.2022, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga kërkuesi dhe i bashkëpandehuri, pasi nuk përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Në datën 06.01.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës, i cili është plotësuar në datën 03.02.2023. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 23.03.2023, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, me qëllim paraqitjen e provave ose argumenteve lidhur me momentin e marrjes dijeni ose/dhe vënies në dispozicion të tij të vendimit nr. 00-2022-713, datë 23.06.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në datën 25.04.2023, sipas shënimit të shërbimit postar, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë plotësimin e kërkesës.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi** ka pretenduar se vendimet objekt kërkesë i kanë cenuar:

5.1. *Të drejtën për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi dosja hetimore përmban akte të cilat nuk mund të përdoren si prova, si: procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e faktorit plotësues të qitjes ndaj kërkuesit, për arsye se është përpiluar konform nenit 191 të KPP-së, i cili nuk ka lidhje me këtë veprim, si dhe është bërë pa një vendim të prokurorit dhe pa ndjekur procedurën ligjore; vendimi për kryerjen e ekspertimit kimik i datës 20.09.2012 nuk i është komunikuar kërkuesit dhe nuk qartësohen veprimet që janë kryer në lidhje me bluzën e sekuestruar atij; vendimet e ekspertimit kimik të datave 04.10.2012 dhe 25.07.2013 nuk përmbajnë deklaratën e ekspertit; procesverbali për marrjen e faktorëve plotësues të qitjes në automjet është një veprim i ripërsëritur, ku megjithëse në kontrollin e parë nuk janë gjetur këta faktorë, në

kontrollin e dytë rezulton se janë të pranishëm. Prokuroria ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga kanosje në tentativë për vrasje, pavarësisht se nga provat vërtetohet se qitjet nuk janë bërë me qëllim marrjen e jetës së personave.

5.2. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi barra e provës për të provuar akuzën i takon organit të akuzës, i cili duhet të krijojë bindjen “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” se vepra penale është kryer nga i pandehuri. Asnjë nga dëshmitarët e sjellë nga prokuroria, të cilët janë pyetur gjatë gjykimit, nuk kanë përmendur faktin se kërkuesi dhe i pandehuri tjetër të kenë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes. Edhe të dhënat e kompanive celulare të paraqitura si prova nga prokuroria nuk e vërtetojnë akuzën, pasi rezulton se kërkuesi dhe i pandehuri tjetër nuk kanë komunikuar midis tyre ditën e ngjarjes. Përfundimi i prokurorisë se thirrjet telefonike nisen nga një fshat i cili ndodhet shumë pranë vendit të ngjarjes, nuk janë të vërteta, pasi në fakt ai ndodhet 25 km ose 40 minuta larg. Gjithashtu, edhe në lidhje me ekspertimin kimik të kryer për të evidentuar praninë e faktorëve plotësues të qitjes me armë në trupin e kërkuesit dhe automjet, eksperti i pyetur në gjyq ka deklaruar se nuk mund të pranojë me siguri se ato janë shkakuar nga qitja me armë zjarri, por mund të vijnë edhe nga burime të tjera.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimit të këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin janë marrë vendimet objekt kundërshtimi, si dhe është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta.

9. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore që e kanë deklaruar fajtor dhe e kanë dënuar me 23 vjet burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/ë, 25, 22 dhe 278, paragrafi 2, të KP-së. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-713, datë 23.06.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të tij. Në këtë situatë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara, për rrjedhojë ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, individ mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatë brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Nenet 142, pika 1 dhe 146, pika 2, të Kushtetutës parashikojnë detyrimin për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe për shpalljen publikisht të tyre në çdo rast. Afati 4-mujor llogaritet nga data e dhënies së vendimit nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme nga data e vendimit.

12. Në argumentet e datës 25.04.2023, në drejtim të legjitimitimit *ratione temporis*, kërkuesi Ilir Hoxha i është drejtuar Gjykatës, pas vendimit të datës 23.03.2023 të Kolegjit të kësaj Gjykate, duke parashtruar se i ndodhur në kushtet e izolimit pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier (*IEVP, Fier*) dhe mungesës së një përfaqësuesi ligjor, nuk është vënë në dijeni të vendimit nr. 00-2022-713, datë 23.06.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Nga materialet e vëna në dispozicion nga kërkuesi, Kolegji vëren se sipas shkresës nr. 1211, datë 20.04.2023 të IEVP-së, Fier, rezulton: “... *ju bëjmë me dije se në dosjen*

tuaj penale nuk ndodhet vendimi nr. 00-2022-713, datë 23.06.2022 i Gjykatës së Lartë si dhe nga verifikimi i librit të protokollit nuk është protokolluar pranë institucionit tonë ky vendim dhe për pasojë nuk iu kemi njoftuar për këtë vendim”. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

13. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, pretendimet e kërkuesit *prima facie* janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

14. Sipas kërkuesit, dosja hetimore përmban akte të cilat nuk mund të përdoren si prova, të tilla si: procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e faktorit plotësues të qitjes ndaj kërkuesit për arsye se është përpiluar konform nenit 191 të Kodit të Procedurës Penale, i cili nuk ka lidhje me këtë veprim, si dhe është bërë pa një vendim të prokurorit dhe pa ndjekur procedurën ligjore; vendimi për kryerjen e ekspertimit kimik i datës 20.09.2012 nuk i është komunikuar kërkuesit dhe nuk qartësohen veprimet që janë kryer në lidhje me bluzën e sekuestruar kërkuesit; vendimet e ekspertimit kimik të datave 04.10.2012 dhe 25.07.2013 nuk përmbajnë deklaratën e ekspertit; procesverbali për marrjen e faktorëve plotësues të qitjes në automjet është një veprim i ripërsëritur, ku megjithëse në kontrollin e parë nuk janë gjetur këta faktorë, në kontrollin e dytë rezulton se janë të pranishëm. Prokuroria ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga kanosje në tentativë për vrasje, pavarësisht se nga provat vërtetohet se qitjet nuk janë bërë me qëllim marrjen e jetës së personave.

15. Sipas nenit 32, pika 2, të Kushtetutës askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre (*shih vendimin nr. 57, datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka evidentuar dallimin që ekziston midis mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete janë, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe

kontrollit të kësaj Gjykate, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo të vlerësimit të tyre. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë, gjithashtu, në kompetencë të saj. Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata e zakonshme mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar në dispozitat procedurale, çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit e nuk ka vlerë të paracaktuar dhe gjykata i vlerëson ato sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal, pasi sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues e bën procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese (*shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret pretendimet e kërkuesit lidhen me faktin se në dosjen hetimore ndodhen disa akte të cilat nuk mund të përdoren për të përcaktuar fajësinë e tij. Rezulton se gjatë gjykimit, kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, i ka kundërshtuar këto akte, për të cilat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendim të ndërmjetëm ka vendosur rrëzimin e tyre si të pabazuara në ligj, duke dhënë edhe argumentet përkatëse. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Apelit Vlorë, e cila ka argumentuar se provat e paraqitura prej palëve i janë nënshtruar debatit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Edhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar se megjithëse në rekurs kërkuesi Ilir Hoxha ka pretenduar pavlefshmërinë e disa akteve procedurale, e për rrjedhojë papërdorshmërinë e tyre, gjykata e shkallës së parë i ka marrë në shqyrtim këto pretendime dhe me të drejtë, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur rrëzimin e tyre, si të pabazuara në ligj (*shih paragrafin 23 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

19. Nga sa më lart, Kolegji vëren se kërkuesi i ka ngritur pretendimet në lidhje me mënyrën e marrjes së provave përpara gjykatave të zakonshme, çka nënkupton se atij i është dhënë mundësia për të vënë në dukje mangësitë e provave nga ana formale, si dhe për të kundërshtuar autenticitetin dhe ligjshmërinë e tyre. Këto pretendime të kërkuesit kanë marrë përgjigje nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Gjithashtu, gjykatat i kanë mbështetur vendimet e tyre jo vetëm në provat e kundërshtuara si të pavlefshme nga kërkuesi, por edhe në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit, si fakti se kërkuesit i janë gjetur faktorë

plotësues të qitjes si në dorën e djathtë dhe bluzën që ai kishte veshur ashtu dhe në automjet; thirrjet telefonike nga numri i telefonit të tij; mungesa e alibisë dhe dëshmitë kontradiktore. Lidhur me pretendimin për cilësimin e gabuar juridik të veprës penale, Kolegji çmon se argumentet e kërkuarit në këtë drejtim kanë të bëjnë me çështje të marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre, dhe nisur nga natyra ligjore e këtij pretendimi, zgjidhja e tij nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

20. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë

21. Kërkuari ka pretenduar se barra e provës për të provuar akuzën i takon organit të akuzës, i cili duhet të krijojë bindjen “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” se vepra penale është kryer nga i pandehuri. Asnjë nga dëshmitarët e sjellë nga prokuroria, të cilët janë pyetur gjatë gjykimit, nuk kanë përmendur faktin se kërkuari dhe i pandehuri tjetër kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes. Edhe të dhënat e kompanive celulare të paraqitura si prova nga prokuroria nuk e vërtetojnë akuzën, pasi rezulton se kërkuari dhe i pandehuri tjetër nuk kanë komunikuar midis tyre ditën e ngjarjes. Përfundimi i prokurorisë se thirrjet telefonike nisen nga një fshat i cili ndodhet shumë pranë vendit të ngjarjes, nuk janë të vërteta, pasi në fakt ai ndodhet 25 km ose 40 minuta larg. Gjithashtu edhe në lidhje me ekspertimin kimik të kryer për të evidentuar praninë e faktorëve plotësues të qitjes me armë në trupin e kërkuarit dhe automjet, eksperti i pyetur në gjyq ka deklaruar se nuk mund të pranojë me siguri se ato janë shkaktuar nga qitja me armë zjarri, por mund të vijnë edhe nga burime të tjera.

22. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t’u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta

dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin në shqyrtim, referuar vendimit nr. 4070 (676), datë 05.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se për deklarimin e fajësisë së kërkuesit kjo gjykatë ka marrë disa indicie, të cilat i ka konsideruar të rëndësishme, sikurse u theksua më lart: kërkuesit i janë gjetur faktorë plotësues të qitjes si në dorën e djathtë dhe bluzën që ai kishte veshur ashtu dhe në automjet; thirrjet telefonike nga numri i telefonit të tij; mungesa e alibisë dhe dëshmitë kontradiktore etj. Këto konkluzione janë mbështetur edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila i ka vlerësuar këto pretendime, duke mos marrë parasysh dëshmitë e të afërmve të kërkuesit, si dhe duke u bazuar në faktin se ai nuk ka shpjeguar arsyen përse faktorët plotësues të qitjes janë gjetur vetëm në dorën e djathtë, pavarësisht deklarimeve për mundësinë e prejardhjes së ndryshme të këtyre faktorëve. Kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për këtë pretendim është shprehur se në rekurs kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e faktit, duke e konsideruar deklarimin fajtor të tij si të pambështetur në provat e marra në gjykim. Ky kolegji ka rikonfirmuar qëndrimin se pjesa e pretendimeve që lidhet me provat dhe mënyrën e vlerësimit të tyre është një çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, e cila është vetëm një gjykatë ligji dhe e merr në shqyrtim rekursin vetëm për shkaqe që parashikohen shprehimisht në nenin 432 të KPP-së (*shih paragrafin 26 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

24. Për sa më sipër, Kolegji vëren se nuk rezulton që gjykatat të kenë shqyrtuar çështjen me prezumimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet ose që të kenë kaluar gjatë procesit barrën e provës nga prokurori tek i pandehuri. Po kështu, nuk rezulton që provave dhe dëshmive të administruara t'u jetë dhënë një vlerë e paracaktuar, por ato janë vlerësuar në gjykim së bashku dhe në unitet me provat e tjera të administruara në proces. Gjykatat e kanë bazuar vendimin për deklarimin fajtor dhe dënimin e kërkuesit mbi një sërë provash të administruara në gjykim dhe të shqyrtuara e vlerësuara prej tyre në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën, duke mos arritur në një konkluzion *apriori* për fajësinë e tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.